

XIV KOMITETI PËR MARRËDHËNIE NË MES TË BASHKËSIVE

1. Për Këshillin për marrëdhëniet ndëretnike

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë në vitin 1991 parashikoi krijimin e një organi të veçantë – Këshilli për marrëdhëniet ndëretnike i cili si detyrë kryesore kishte shqyrtimin e çështjeve mbi marrëdhëniet ndëretnike në Republikën e Maqedonisë dhe të japë mendime dhe propozime për zgjidhjen e tyre. Kuvendi ishte i detyruar t'i shqyrtojë mendimet dhe propozimet e Këshillit dhe të sjellë vendime në lidhje me to.

Këshilli për marrëdhëniet ndëretnike u krijua nga Kuvendi i RM-së. Anëtarët e Këshillit i propozonte Presidenti i RM-së, ndërsa i zgjidhte Kuvendi i RM-së. Këshillin për marrëdhëniet ndëretnike përbëhej nga:

- kryetari i Kuvendit të RM-së;
- dy maqedonas;
- dy shqiptarë;
- dy turq;
- dy vllhë;
- dy romë;
- dy anëtarë nga nacionalitetet e tjera në RM-së.

Kryetari i Këshillit, ishte Kryetari i Kuvendit të RM-së.

Me amendamentet kushtetuese të vitit 2001 ky organ u zëvendësua me Komitetin për marrëdhënienë mes të bashkësive.

1. Për Komitetin për marrëdhëniet në mes të bashkësive

Komiteti për marrëdhëniet mes bashkësive është organ i autorizuar që t'i shqyrtojë marrëdhëniet mes bashkësive në Republikën e Maqedonisë dhe të japë mendime dhe propozime për zgjidhjen e tyre. Kuvendi është i detyruar t'i shqyrtojë mendimet dhe propozimet e Komitetit dhe të sjellë vendime në lidhje me to. Komiteti vendos edhe në rast konflikti që mund të dalë gjatë votimit të ligjeve për votimin e të cilëve është e nevojshme edhe shumica e votave të deputetëve të pranishëm të cilët u përkasin bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë. Në rast konflikti të këtillë Komiteti vendos me shumicë të votave të anëtarëve për atë se a do të zbatohet procedura për votim të këtillë.

Komiteti për marrëdhëniet mes bashkësive nuk është i përbërë në bazë të paritetit (me numër të barabartë përfaqësuesish), siç ishte rasti me Këshillin për marrëdhëniet ndëretnike. Gjithashtu, Komiteti për marrëdhëniet mes bashkësive përbehet nga 19 anëtarë, të cilët janë deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, për dallim nga Këshilli për marrëdhëniet ndëretnike, anëtarët e të cilit nuk ishin deputet, por persona jashtë Kuvendit. Përderisa ndonjëra nga bashkësitë nuk ka asnjë deputet, Avokati

popullor, pas konsultimit me përfaqësuesit relevantë të këtyre bashkësive, do t'i propozojë anëtarët e Komitetit nga gjiri i këtyre bashkësive.

Komiteti për marrëdhëniet mes bashkësive përbëhet nga:

- shtatë maqedonas;
- shtatë shqiptarë;
- një turk;
- një vllah;
- një rom;
- një serb dhe;
- një boshnjak.

Kryetari i Komitetit për marrëdhëniet mes bashkësive zgjidhet nga gjiri i anëtarëve të tij.

PYETJE:

1. Kush i propozon anëtarët e Këshillit për marrëdhënie ndëretnike?
2. Kush i zgjedh anëtarët e Këshillit për marrëdhënie ndëretnike?
3. Kush e përbën Këshillin për marrëdhëniet ndëretnike?
4. Çka përfshin kompetenca e Këshillit për marrëdhënie ndëretnike?
5. Kush udhëheq me Këshillin për marrëdhënie ndëretnike?
6. Kush e përbën Komitetin për marrëdhëniet mes bashkësive?
7. Çka përfshin kompetenca e Komitetit për marrëdhënie mes bashkësive?